



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR**

Nr. 979 Prot

Shkodër, më 19.01.2021

**URDHËR ANKANDI**

Nr. 44 Datë 19.01.21

**“PËR KRIJIMIN E NJËSISË SË ANKANDIT ME OBJEKT: “SHITJEN ME ANKAND TË AKSIONEVE TË KLUBIT TË FUTBOLLIT ‘VLLAZNIA’ SHA NË MASËN 100%”**

Mbështetur në ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr. 9874 datë.14.02.2008 “Për ankandin publik” i ndryshuar; ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, ligji nr.79/2017 “Për sportin” i ndryshuar; VKM nr.1719 datë.17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” të ndryshuar; VKB nr.54, datë 27.11.2020 “Për miratimin për shitjen me ankand të aksioneve të Klubit të Futbollit “Vllaznia” sha në masën 100%”

**URDHËROJ:**

1. Të kryhet procedura e ankandit publik me objekt “Shitjen me ankand të aksioneve të klubit të futbollit ‘Vllaznia’ sha në masën 100%”
2. Vlera fillestare e ankandit është 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë.
3. Lloji i procedurës së ankandit është “Procedure e hapur”.

Arsyet e përdorimit të procedurës së mësipërme të ankandit janë:

Procedura e hapur mund të përdoret në të gjitha kontratat publike.  
Procedura e hapur është procedura e preferuar në ankandin publik.  
Nxit pjesëmarrjen dhe konkurrencën e ofertues.

4. Njësia e ankandit do të përbëhet nga:

- |             |            |         |
|-------------|------------|---------|
| • Terezina  | Hila       | Kryetar |
| • Vinifreda | Gazulli    | Anetar  |
| • Manjola   | Fushaxhija | Anetar  |

Njësia e ankandit është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të ankandit, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave dhe për kryerjen e të gjitha veprimeve e procedurave në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e ankandit publik në fuqi.

5. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Njësia e Ankandit.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**TITULLARI I AUTORITETIT SHITËS**

**VOLTANA ADEMI**



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPERISE" at the top and "BASHKIA SHKODËR" at the bottom, with a central emblem of the Albanian coat of arms. A long, thin blue line extends from the bottom of the stamp downwards.